

Fjala e Guvernatorit në Punëtorinë Rajonale të FSDK-se më 4 maj 2015

I nderuari z. Zëvendësministër i Financave Krasniqi,
Të nderuar përfaqësues të IADI-it dhe të anëtarëve të IADI-it,
Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në Kosovë,
Zonja dhe zotërinj,

Kam nderin t'ju uroj mirëseardhje në Punëtorinë Rajonale të IADI-it për Vlerësimin e Pajtueshmërisë me Parimet Themelore për Sisteme Efektive të Sigurimit të Depozitave. I jemi mirënjohës Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI-it) për mundësinë e dhënë që FSDK-ja të jetë nikoqire e ngjarjes dhe që Sistemi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës të vlerësohet me Parimet Themelore të rishikuara.

Fillimisht, dua të theksoj se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) si institucion kryesor pjesëmarrës dhe rregullativ në sistemin financiar të vendit ka për objektiv parësor nxitjen dhe mbajtjen e stabilitetit të sistemit financiar, duke përfshirë ushtrimin e detyrave të mbikëqyrjes së sektorit bankar dhe të skemës së sigurimit të depozitave. Sektori bankar i Kosovës paraqet komponentin kyç të sistemit financiar dhe në vazhdimësi ka shënuar progres, duke sjellë edhe zhvillim të kënaqshëm të sektorëve të tjerë financiarë, të infrastrukturës dhe tregjeve financiare, si dhe duke promovuar në mënyrë të theksuar zhvillimin ekonomik të vendit. Indikatorët kryesorë të sektorit bankar shprehin qartë gjendjen dhe ecuritë pozitive të tij. Në këtë rast, vlen të ceket se në fund të tremujorit të parë të këtij viti, gjithsej mjetet e sektorit bankar tejkalojnë shumën prej 3 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7%. Ngjashëm, në fund të kësaj periudhe, gjithsej depozitat arritën në shumën prej afro 2,6 miliardë euro, duke evidentuar rritje vjetore prej 6%. Po ashtu duhet shtuar se edhe vlerësimet e BQK-së për zhvillimin e sektorit bankar në periudhat e ardhshme janë pozitive.

Që në vitin 2007, BQK-ja ka nisur themelimin e Sistemit të Sigurimit të Depozitave duke u përkrahur nga Qeveria e Gjermanisë, përmes KfW-së, si projekt zhvillimor. Progresi i parë në këtë drejtim është shënuar me miratimin e Ligjit për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave në fund të vitit 2010, i cili në përmbajtjen e tij ka adoptuar një seri praktikash më të mira ndërkombëtare, siç janë: pavarësia institucionale, zbatimi i premiumit diferencues, sigurimi i kufizuar i depozitave, përfshirja në sigurimin e depozitave të personave fizikë dhe juridikë, sigurimi i

depozitave për depozitorë për çdo bankë e kështu me radhë. Themelimi i Sistemit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë, si projekt në kuadër të bashkëpunimit bilateral Kosovë-Gjermani, është arritur me nënshkrimin e Marrëveshjes trepalëshe të Financimit dhe Projektit në mes të Qeverisë së Kosovës, përmes Ministrisë së Financave, Qeverisë së Gjermanisë, përmes KfW-së, dhe FSDK-së, e cila ka formalizuar mbështetjen me kontribut të kapitalit si donacion për FSDK-në në shumë totale prej 15,5 milionë euro. Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Financave, ka kontribuar 11 milionë euro, ndërsa Qeveria e Gjermanisë, përmes KfW-së, ka siguruar 4,5 milionë euro kontribut në kapital. Qeveria e Gjermanisë, përmes KfW-së, ka kontribuar edhe 0,5 milion euro në shërbime të shoqëruara këshillimore. Vlen të përmendet se pjesa e kontributit në kapital nga Qeveria e Kosovës në shumën prej 2,9 milionë euro është financuar nga Banka Botërore, përmes një kredie të IDA-së. Banka Botërore gjithashtu ka kontribuar me asistencë teknike në ngritje të kapaciteteve institucionale.

Më pas, në vitin 2013, në mbështetje të rritjes së limitit të sigurimit gradual nga 2.000 euro, sa ishte fillimisht, në 3.000 euro - më 01.01.2014, në 4.000 euro më 01.01.2016 dhe në 5.000 euro më 01.01.2018, FSDK-ja ka pranuar një kontribut shtesë kapitali në formë donacioni nga Qeveria e Gjermanisë, përmes KfW, në vlerë prej 2 milionë euro, e formalizuar me Marrëveshjen e dytë të Financimit dhe Projektit të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës, përmes Ministrisë së Financave, Qeverisë së Gjermanisë, përmes KfW dhe FSDK-së.

Shfrytëzoj këtë rast të shpreh edhe një herë falënderimet për KfW-në, në emër të Qeverisë së Gjermanisë, Ministrinë e Financave, në emër të Qeverisë e Kosovës, dhe Bankën Botërore për mbështetjen në themelimin dhe kapitalizimin e sistemit të sigurimit të depozitave në Kosovë.

Si partnere në mbështetje të Sistemit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë, FSDK-ja ka siguruar nga BERZH-i qasje në huamarrje me garanci shtetërore nga Qeveria e Kosovës prej 10 milionë euro. Linja kreditore në “stand-by” do të shfrytëzohet vetëm në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve dhe plotëson të vetmin kusht të zbatimit të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit me KfW, në emër të Qeverisë së Gjermanisë dhe Ministrinë e Financave, në emër të Qeverisë së Kosovës. Në kuadër të bashkëpunimit teknik, BERZH-i do të financojë shumicën e kostos prej 238 mijë euro për zhvillimin dhe implementimin e Sistemit për Kompensimin e Depozitorëve.

Siç jeni në dijëni, Parimet Themelore, të lëshuara fillimisht nga IADI dhe Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare në vitin 2009, japin udhëzime të politikave për përgatitje të sistemeve për sigurim të depozitave, duke identifikuar në mënyrë specifike drejtimin e gjerë të politikës për sisteme efektive të sigurimit të depozitave. Parimet Themelore, gjithashtu, shfrytëzohen edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga Banka Botërore, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar, për të vlerësuar efektivitetin e sistemeve për sigurim të depozitave për juridiksionet dhe për praktikën përkatëse. Jemi të privilegjuar që vlerësimi i pajtueshmërisë së Sistemit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës do të bëhet duke përdorur Parimet Themelore të rishikuara të miratuara në muajin tetor 2014 dhe të pranuar nga Bordi i Stabilitetit Financiar për përfshirjen në Standardet Përmbledhëse të tij në muajin janar 2015. Shfrytëzoj rastin të uroj IADI-in, si përcaktues i standardeve, për këtë arritje madhore.

Jemi në dijëni se ekipi vlerësues përbëhet nga ekspertë të njohur të sigurimit të depozitave që kanë marrë pjesë në hartimin e Parimeve Themelore, prandaj i falënderoj të gjithë për kohën dhe për kontributin e tyre të çmueshëm në procesin e vlerësimit të Sistemit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës.

Një nga qëllimet strategjike të FSDK-së për ta arritur vizionin e saj është arritja e pajtueshmërisë me Parimet Themelore, prandaj vlerësimi gjatë kësaj punëtorie është me rëndësi madhore për FSDK-në për të kuptuar në mënyrë të saktë rrugën e përmirësimit të qëllimit strategjik dhe vizionit. Mirëpresim që vlerësimi do të jetë gjithëpërfshirës dhe i orientuar në veprime konkrete me fokus në Sistemin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë dhe relacionet e tij me Rrjetin e Sigurisë Financiare për funksionet që mbështetën nga institucionet përkatëse. Vlerësimi i pajtueshmërisë me Parimet Themelore do të identifikojë përparësitë dhe dobësitë në sistemin ekzistues të sigurimit të depozitave dhe do të formojë një bazë për masë përmirësuese nga FSDK-ja dhe politikë-bërësit.

Vlerësimi i pajtueshmërisë së Sistemit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë me Parimet Themelore është gjithashtu pjesë e vlerësimit përmbyllës të Projektit të Bankës Botërore për Forcimin e Sektorit Financiar dhe Infrastrukturën e Tregut.

Në fund, ju uroj punë të mbarë gjatë tri ditëve të punëtorisë.

Ju faleminderit për vëmendjen.